

FLETËPALOSJE - INFORMACION PËR PËRDORUESIT

ALRINAST 5 mg: Tabletë e veshur me cipë.



Për përdorim nga goja

- **Principi aktiv:** Cdo tabletë e veshur me cipë përmban 5 mg desloratadine.
- **Eksipientë:** dibasic fosfat kalciumi dihidrat, monohidrat laktozë, hipermelozë, celulozë mikrokristaline, niseshte misri, pudër, dioksid titaniumi, glikol polietileni, FD & C blu No: 2.

Lexoni me kujdes te gjithë këtë fletëpalosje para se të nisni përdorimin e këtij bari, sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

- Mbajeni këtë fletëpalosje. Mund të keni nevojë ta lexoni sërish.*
- Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme, konsultoni mjekun tuaj ose farmacistin.*
- Ky bar është përshkruar vetëm për ju, mos ua sygjeroni personave të tjerë.*
- Informoni mjekun tuaj që jeni duke u trajtuar më këtë bar, në rast se bëni vizitë tek mjeku ose jeni në spital.*
- Ndiqui rreptësisht udhëzimet në këtë fletëpalosje informative. Mos përdorni doza më të larta ose më të ulëta, përveç se ajo që është rekomanduar për ju.*

Në këtë fletëpalosje:

1 Çfarë është ALRINAST dhe përse përdoret?

2 Përpara se të përdorni ALRINAST

3 Si ta përdorni ALRINAST?

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore ?

5 Si të ruani ALRINAST

Janë përfshirë.

1. Çfarë është ALRINAST dhe përse përdoret?

ALRINAST 5 mg tabletë e veshur me cipë të hollë, ngjyrë blu e çelët, në formë të rrumbullakët dhe janë të disponueshme në paketa me blistera që përmbajnë 20 tableta.

ALRINAST, është një bar antialergjik, që nuk ju jep përgjumje. Bari ndihmon për të kontrolluar reaksionin alergjik dhe simptomat e saj.

ALRINAST qetëson simptoma të tilla, si tështitje, hundë që rrjedhin ose të irrituara, qiellzë e pezmatuar, sy të kuq, të përlotur apo të irrituar [për shembull, (pollinosis / (hay fever), ose alergji prej isekteve të pluhurit] lidhur me rinitet alergjike

ALRINAST është përdorur edhe për eliminimin e simptomave të tilla si eliminimi i irritimeve si urtikarie, ënjtje dhe skuqje të lëkurës

Këto simptoma qetësohen përgjatë ditës, dhe trajtimi me këtë bar, ju ndihmon për të rifituar veprimtarinë tuaj normale të përditshme dhe gjumin.

2. Përpara se të përdorni ALRINAST

MOS PËRDORNI ALRINAST në kushtet e përcaktuara më poshtë;

Nëse;

- Ju keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj desloratadine, loratadine apo ndonjë nga përbërësit e tjerë të këtij bari.

PËRDORENI ALRINAST ME KUJDES në kushtet e përcaktuara më poshtë;

- Përdoreni me kujdes në dëmtimet në veshka.

Nëse, ndonjë prej këtyre paralajmërimeve përputhet me gjendjen tuaj të tanishme, apo me çdo periudhë në të kaluarën, ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj.

Përdorimi i ALRINAST me ushqim dhe pije

ALRINAST 5 mg mund të merret me ushqim ose më vete (i pa shoqëruar me ushqim)

Shtatzënia:

Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Mos e merrni ALRINAST, nëse jeni shtatzënë.

Në rast se, ju vini re se jeni shtatzënë gjatë terapisë tuaj, konsultohuni me mjekun tuaj menjëherë.

Ushqyerja me gji:

Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Mos e merrni ALRINAST gjatë periudhës së ushqyerit me gji.

Drejtimi dhe përdorimi i makinerive

Dozën e rekomanduar e ALRINAST, nuk pritët të ndikojë në aftësinë tuaj për të drejtuar një makinë, ose të përdorni makineri. Megjithatë, shumë rrallë, ALRINAST mund të krijojë marramendje në disa pacientë, dhe kjo mund të ndikojë gjatë drejtimit të makinës dhe përdorimit të makinerive.

Informacion i rëndësishëm në lidhje me disa përbërës të ALRINAST

ALRINAST përmban laktozë (sheqer qumështi). Nëse ju është thënë nga mjeku juaj, që keni intolerancë për lloje të caktuara të sheqerit, kontaktoni me mjekun tuaj para se të merrni këtë produkt.

Përdorimi i barnave të tjera

Nuk ka ndërveprime të njohura të ALERINAST me barna të tjera

Në qoftë se aktualisht, apo së fundmi, merrni, ose keni marrë ndonjë bar të përshkruar me ose pa recetë, ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj

3 Si ta përdorni ALRINAST?

Udhëzime për përdorimin e duhur dhe shpeshtësinë e dozës

Të rriturit dhe adoleshentët 12 vjeç e sipër: Merrni një tabletë, një herë në ditë. Tabletat merren me ujë, shoqëruar, ose jo, me ushqim. Lidhur me kohëzgjatjen e trajtimit, mjeku juaj do të përcaktojë llojin e rinitit alergjik, prej të cilit ju vuani, dhe rrjedhimisht, do të përcaktojë për sa kohë ju duhet të trajtoheni me ALRINAST.

Nëse riniti juaj alergjik është sporadik (prania e simptomave për një kohëzgjatje më pak se 4 ditë në javë, ose për më pak se 4 javë), mjeku juaj do t'ju rekomandojë një plan trajtimi, që do të varet nga vlerësimi i historisë së sëmundjes tuaj.

Nëse riniti juaj alergjik është i vazhdueshëm (prania e simptomave me një kohëzgjatje 4 ditë ose më tepër gjatë javës, dhe për më gjatë se 4 javë), mjeku juaj mund t'ju rekomandojë një trajtim më afatgjatë.

Për sa i përket urtikarieve, kohëzgjatja e trajtimit mund të ndryshojë nga një pacient në tjetër, dhe për këtë arsye, ju duhet të ndiqni udhëzimet e mjekut tuaj.

Rruga dhe mënyra e përdorimit:

Gëlltiteni të gjithë tabletën, shoqëruar ose jo me ushqim, dhe me një gotë ujë. Ju duhet të vazhdoni të merrni tabletat brenda kohës së përcaktuar nga mjeku juaj.

Grupmosha të ndryshme :

Përdorimi në fëmijë:

ALRINAST është i përdorur vetëm në të rriturit dhe fëmijët 12 vjeç e sipër.

Përdorimi tek të moshuarit :

Siguria dhe efikasiteti i ALRINAST nuk është përcaktuar.

Kushtet e veçanta e përdorimit:

Përdorimi në insuficiencën hepatiche

Nuk ka të dhëna në lidhje me përdorimin në insuficiencën hepatiche

Përdorimi në insuficiencën renale

ALRINAST duhet të përdoret me kujdes në pacientët me pamjaftueshmëri të rëndë të veshkave.

Nëse ju vini re se efikasiteti i ALRINAST është i fuqishëm apo i dobët, konsultohuni me mjekun ose farmacistin.

Nëse ju merrni më shumë ALRINAST se ju duhet:

Merreni ALRINAST vetëm ashtu siç është përshtetur për ju. Nuk priten probleme serioze shkaktuar nga marrja e mbidozës aksidentale.

Nëse ju merrni më shumë sasi të ALRINAST, se sa ju duhet, konsultohuni me një mjek ose farmacist.

Nëse ju harroni të merrni ALRINAST

Nëse ju harroni të merrni dozën tuaj në kohë, merreni atë menjëherë, sapo t'ju kujtohet, dhe më pas, vazhdoni me orarin tuaj të rregullt të marrjes së dozës.

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar.

Në qoftë se ndërprisni terapinë me ALRINAST

Nuk ka asnjë efekt të raportuar.

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore?

Ashtu si të gjitha barnat, pacientët me ndjeshmëri ndaj përbërësve të ALRINAST, mund të përjetojnë efekte anësore. Efektet anësore tek të rriturit ishin gati të ngjashme si me trajtimin me një placebo (një lloj bari jo-terapeutik). Megjithatë, lodhje, goja e thatë dhe dhimbje koke u raportuan më shpesh, sesa trajtimi me një placebo. Tek adoleshentët, efekti anësor që raportohet më shpesh, është dhimbja e kokës.

Të zakonshme: Lodhje

Të pazakonshme: Gojë e thatë, dhimbje koke

Këto janë efektet e buta anësore të ALRINAST.

Shumë të rralla: Reaksione alergjike (vështirësi në frymëmarrje, fishkëllima në frymënxjerrje, kruajtje, urtikarie (irritim), Rash/skuqje, iluzione, ishemi, nervozizëm me lëvizshmëri të lartë, palpitacione, përshpejtim të rrahjeve të zemrës, analiza me rezultate jonormale të funksionit të mëlçisë, inflamacion të mëlçisë, marramendje, hiperaktivitet fizik dhe mendor, dhimbje stomaku, të përziera (ndjenja e të vjellit), të vjella, diarre, pagjumësi, të qenët i përgjumur, dhimbje të muskujve, ënjtje.

Nëse vini re ndonjë efekt anësor, i cili nuk përfshihet në këtë fletëpalosje, ju lutem, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. Si ta ruajmë ALRINAST

Ruajeni ALRINAST në temperaturën e dhomës, më poshtë se 25°C. Mbrojeni nga lagështia.

Ruajeni ALRINAST në paketë dhe mbajeni jashtë kontaktit dhe shikimit të fëmijëve.

Përdoreni në përputhje me datën e skadimit.

Mos e përdorni ALRINAST pas afatit të skadencës të shënuar në paketë.

Mos e përdorni ALRINAST, në rast se vini re ndonjë dëmtim në pamjen e jashtme të paketës dhe flisni me farmacistin tuaj.

Mbajtësi i licencës:

Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. Veysel Karani Mah. Colakoglu Sok. No: 10, 34885
Sancaktepe / İstanbul, Turkey

Vendi i prodhimit: Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. A.Ş. 3.Organize Sanayi Bolgesi
Kuddusi Cad. 23. Sok. No: 1 Selcuklu / Konya, Turkey